

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylta, në lëndën penale kundër të pandehurit, E.A., për shkak të veprës penale, falsifikimi i parasë nga neni 302 parag.2 i KPRK-së, të cilin e ka mbrojtur av. H.A. i caktuar sipas autorizimit, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.264/17 të datës 29.12.2017, të cilin e përfaqësonte prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së seancës dëgjimore më 01.03.2018, shpalli publikisht, ndërsa më 09.03.2018 hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E.A., nga babai S. dhe nëna Xh., e lindur A., i lindur më data e lindjes... në ..., me vendbanim në fsh. ... R. ..., ka të kryer fakultetin Turizëm dhe Menaxhment, i pa punësuar, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 14.12.2017, rreth orës 22:40 minuta, duke e ditur se paraaja është e falsifikuar, me dashje e ka futur në qarkullim si të vërtetë, ashtu që i njëjti shkon tek kazino " ... " në rrugën " ... " në ..., fillon të luaj kazino, më pas nga puntori i kazinos – i dëmtuari L.G. kërkon për t'i bërë para të imëta një monedhë prej 100€, i dëmtuari i'a jep parat e imëta, më pas e heton se kartëmonedha është e falsifikuar dhe i'a kthen të pandehurit, puntori i kazinos e thërret policinë dhe nga i njëjti sekuestrohen 5 kartëmonedha nga 100€, pas ekzaminimit nga Njësia e Forenzikës e Policisë së Kosovës, kanë rezultuar si të falsifikuara, ndërsa i pandehuri është arrestuar.

Me çka ka kryer veprën penale, falsifikimi i parasë nga neni 302 paragrafi 2 i KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuara ligjore si dhe neneve 4,7, 41, 42, 45,46, 47, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-së të pandehurit, i shqipton :

DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit E.A., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, në të cilin dënim, i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.12.2017 e deri më 29.12.2017, gjykata me pëlqimin e të pandehurit dhe në pajtim me nenin 47 të KPRK-së, dënimin e mbetur me burgim i'a zëvendëson me dënim me gjobë në shumë prej 2500€ (dymijëpesëqind) Euro, të cilën gjobë detyrohet që ta paguaj në afat prej (3) tre muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pagesa bëhet në këste të barabarta mujore edhe atë duke filluar nga java e parë e muajit vijues.

Nëse i pandehuri në fjalë nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e përcaktuar me këtë aktgjykim, atëherë, dënimi me gjobë do t'i revokohet ashtu që i pandehuri, detyrohet që ta mbajë dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 165 (njëqind e gjashtëdhjetë) ditëve.

Detyrohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €(njëzetë)Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës se prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata në kuptim të nenit 69 parag. 1 dhe 2 e në lidhje me nenin 62 parag. 2 dhe nën parag.2.6 të KPRK-së, i konfiskohet kartëmonedhat: 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ... dhe 1x100 Euro me numër serik ... të sekuestruara me datën 15.12.2017

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Deparatamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.264/17 të datës 29.12.2017, kundër të pandehurit E.A., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 parag.2 i KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjilan-Deparatamenti për Krime të Rënda më 29.12.2017 ka paraqitur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga prokurori e shtetit Arben Kadriu, i pandehuri E.A. dhe mbrojtësi i tij, av.H.A.

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore lidhur me shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Arben Kadriu, i pandehuri E.A. me mbrojtësin e tij, av. H.A. me autorizim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se kemi pranuar kërkesën për fillimin e negociimit për pranimin e fajësisë më datë 29.12.2017, pastaj prokurori i çështjes ka marrë autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDKR në Gjilan, Jetish Maloku dhe kemi filluar të negociojmë me të pandehurin e sipërtheksuar si dhe mbrojtësin e tij, kështu që është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë me të pandehurin e lartëcekur dhe mbrojtësin e tij. Prandaj mbes në tërësi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë ngase janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale, duke pasur parasysh edhe caktimin e dënimin, i cili dënim është paraparë në marrëveshje

Mbrojtësi i të pandehurit E.A., av.H.A., ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim, kemi arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi, andaj i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë, sepse e nejtë është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

I pandehuri E.A. në fjalën e tij deklaroi: në tërësi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratave të palëve, e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPRK-së, gjykata konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTH- DKR, në njërin anë, dhe të pandehurit E.A. me mbrojtësin e tij, në anën tjetër për kryerjen e veprës penale, për shkak të veprës penale, falsifikimi i parasë nga neni 302 parag.2 i KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPRK-së, vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, e që një gjë e tillë është bërë në vazhdim të seancës.

Prokurori i shtetit A.K. ka deklaruar: Mbetem në tërësi pranë marrëveshjes lëndore të nënëshkrur nga palët, duke u pajtuar edhe me dënimin.

Mbrojtësi i të pandehurit E.A., av. H.A., ka deklaruar: si në fillim, por edhe tani theksoi faktin se marrëveshja është arritur në pajtim me dispozitat ligjore se dhe dakordimin e të mbrojturit tim, kështu që kërkoj nga gjykata që të njejtën ta aprovoj, ndërsa me rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë, kërkoj nga gjykata që të ketë parasysht faktin se i njejtë është i pa punësuar dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

I pandehuri E.A., ka deklaruar: e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, pendohem për veprën e kryer, i premtoj gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre apo të ngjajshme, dhe në fund kërkoj nga gjykata që me rastin e zëvendësimit të dënimit me burg në dënim me gjobë të ketë parasysht faktin se unë jam i pa punësuar dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

Pas pranimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të njëjtin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët e tjerë.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 69 parag. 1 dhe 2 e në lidhje me nenin 62 parag. 2 dhe nën parag.2.6 të KPPK-së, i konfiskohet kartëmonedhat: 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ..., 1x100 Euro me numër serik ... dhe 1x100 Euro me numër serik ... të sekuestruara me datën 15.12.2017

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

***Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 12/18, më 09.03.2018***

***Sekretare juridike,
Rafete Sylja, d.v.***

***Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi, d.v.***

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.